

Seance Plene
Zil



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

KUVENDI
NR. 958 DATE 12.03.24

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2024

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga deputeti i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DEPUTETI

Gazment BARDHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.05.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Gazment Bardhi,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas nenit 30, shtohet neni 30/1, me përmbajtje si më poshtë:

Pensionet në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht llojit të tyre, nuk mund jenë më të ulëta se:

- 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në vitin 2024;
- 20.000 (njëzet mijë) lekë në vitin 2025;
- 23.000 (njëzet e tre mijë) lekë në vitin 2026;
- 26.000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në vitin 2027;
- 29.000 (njëzet e nëntë mijë) lekë në vitin 2028;
- 32.000 (tridhjetë e dy mijë) lekë në vitin 2029.

Neni 2

Në nenin 62, pika 3, në fjalinë e parë dhe të dytë, togfjalëshi "...por jo më shumë se për 3 vjet" hiqet.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARJA

Lindita NIKOLLA

Miratuar, më _____.____.2024

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7703, DATË 11.05.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Pandemia botërore COVID-19 dhe agresioni rus ndaj Ukrainës sollën një rritje të përgjithshme të cmimeve të produkteve të ndryshme, duke sjellë një kosto më të lartë të jetesës. Ndër shtresat më të goditura nga rritja e cmimeve dhe inflacioni ishin pensionistët, shumë prej të cilëve u gjendën thuajse në pamundësi për të blerë produktet e shportës ushqimore, ilacet dhe paguar faturat e energjisë dhe ujit. Megjithëse niveli i ulët i pensioneve dhe nevoja për rritjen e tyre është pranuar edhe nga ministri i Financave dhe Ekonomisë gjatë diskutimit të projektbuxhetit për vitin 2024, sërish masat e marra për adresimin e kësaj problematike për shtresën e pensionistëve janë të pamjaftueshme. Indeksi që qeveria ka kryer për të kompensuar pasojat e ndryshimit të cmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura për nivelin minimal të jetesës, nuk ka qenë në përpjestim të drejtë me rritjen e cmimeve të produkteve ushqimore, ilaceve dhe shërbimeve të tjera. Nëse pensionistët nuk do të kishin mbështetjen e familjarëve të tyre që jetojnë brenda apo jashtë vendit, shumë prej tyre do të ishin në pamundësi reale për të përballuar kostot e jetesës.

Nga ana tjetër, legjislacioni aktual për sigurimet shoqërore parashikon se nëse një pensionist nuk tërheq masën e pensionit për tre vitet e fundit, ai e humbet këtë drejtë, megjithëse në të njëjtën dispozitë ligjore (shih nenin 62, pika 2) thuhet se e drejta e pensionit nuk parashkruhet, pra qytetarit nuk i humbet asnjëherë e drejta për të kërkuar përfitimin e pensionit. E drejta e pensionit nuk duhet kuptuar si një lloj mëshire apo bujarie që shteti tregon ndaj qytetarëve të tij, por si një e drejtë që lind pikërisht nga kontributi shumëvjeçar që këta qytetarë i japin shtetit dhe shoqërisë. Pensioni është një formë mirënjohjeje për vitet e gjata të punës dhe sakrificave të këtyre qytetarëve, për të ndërtuar një shoqëri më të mirë e më të zhvilluar. Prandaj, heqja e këtij përfitimi, nëse nuk e tërheq gjatë tre viteve të fundit, është krejtësisht i padrejtë. Arsyet e mostërheqjes së masës së pensionit mund të jenë të ndryshme, duke filluar nga shkaqet objektive, si problemet shëndetësore, të jetuarit jashtë vendit etj., deri te vullneti i lirë që mund të kenë këta pensionistë për të ndihmuar trashëgimtarët e tyre.

Pikërisht, me qëllim adresimin e këtyre shqetësimeve dhe problematikave, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka ndërmarrë një nismë ligjore që synon rritjen e pensioneve minimale, vecanërisht pensionistëve në zonat rurale, duke vendosur një standard minimal të masës së përfitimit, pavarësisht llojit të pensionit, si dhe duke zhbërë ato parashikime ligjore që e kufizojnë të drejtën e përfitimit të pensionit me tërheqjen ose jo të tij gjatë tre viteve të fundit. Përfitimi i pensionit dhe shuma e përfituar janë të drejta që qytetari duhet t'i gëzojë nga mosha e daljes në pension dhe deri në fund të jetës, duke i ofruar edhe mundësinë që këto përfitime t'i përdor vetë për nevojat e tij ose t'i trashëgojë të familjarët e tij, në formën e ndihmës dhe solidaritetit njerëzor.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me qëllim ofrimin e një trajtimi më dinjitoz për prindërit, gjyshërit dhe qytetarët e moshuar të vendit tonë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka përgatitur një projektligj që parashikon dy ndërhyrje në Ligjin aktual nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve synohet jo vetëm arritja e qëllimeve të shpallura në projektligj dhe relacionin shoqëruës, por edhe celja e një debati publik që adreson më mirë shqetësimet dhe sfidat me të cilat përballen sot pensionistët shqiptar. Trajtimi dinjitoz i një prej shtresave më vulnerabël të vendit është një tregues i një shoqërie të emancipuar, në paqe sociale dhe ku vlerësohet drejtë puna dhe sakrificat shumëvjecare të bashkëqytetarëve tanë.

Konkretisht, ndërhyrja e parë synon që të vendosë një standard minimal për masën e përfitimit të pensionit në vendin tonë, pavarësisht llojit të këtij pensioni, duke filluar nga viti 2024 në masën e pensionit mesatar rreth 18 mijë lekë dhe duke vijuar në progresion rritës për 5 vitet e ardhshme, me qëllim që në vitin 2029 të mos ketë pensione më të ulëta se 32 mijë lekë (rreth 300 euro). Ky propozim është në harmoni me propozimin e mëparshëm të deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për minimumin jetik në masën 20 mijë lekë (rreth 200 euro). Qeveria shqiptare i ka mundësitë financiare për të përballuar këtë kosto financiare, nëse fondet e saj nuk do t'i alokojë për mobilime zyrash, blerja makinash, karburant (konkretisht ulja me 25% e shpenzimeve operative të qeverisjes qëndrore), si dhe tendera e koncesione që pasurojnë oligarkët, por që mbështesin shtresën e pensionistëve për t'u ushqyer më mirë, për t'u kujdesur për shëndetin dhe për të përballuar kostot e jetesës. Kjo masë përfitimi është pothuajse e barabartë dhe në disa raste më e ulët se përfitimet që kanë pensionistët në vendet e rajonit, si Kosova (309 euro), Mali i Zi (425 euro), Maqedonia e Veriut (320 euro) dhe Serbia (390 euro).

Ndërsa, ndërhyrja e dytë ka të bëjë me garantimin e të drejtës së përfitimit dhe marrjes së këtij përfitimi përgjatë gjithë jetës së një pensionisti, pavarësisht kohës kur ai zgjedh me vullnetin e lirë të tij ta tërheqë masën e pensionit. Një pensionist mund të gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për t'u paraqitur personalisht dhe tërhequr pensionin, sic është rasti i bërë publik nga emisioni “Stop” në TV Klan në datën 28 shkurt 2024, ashtu si edhe në rastin kur një pensionist, i cili gëzon mundësitë ekonomike, ka dëshirë që kursimet e tij nga pensioni t'i përdorë për t'iu ardhur në ndihmë fëmijëve, nipërve, mbesave apo familjarëve të tjerë. Heqja e parashikimeve që e kushtëzojnë tërheqjen e masës së përfitimit me afatin 3-vjecar është edhe në përputhje me nenin 62, pika 2, që sanksionon shprehimisht se e drejta e pensionit nuk parashkruhet, pra qytetari mund ta kërkojë në cdo kohë përfitimin e kësaj të drejte. Pensioni nuk duhet kuptuar në asnjë rast si dhuratë apo mëshirë, por duke qenë se rrjedh nga kontribute shumëvjecare, si një e drejtë e patjetërsueshme që ka cdo qytetar për të përballuar kostot e jetesës në vitet që nuk është aktiv për punë.

III. VLERESIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është propozim i një deputeti të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 3 dispozita.

Neni 1 parashikon shtimin e nenit 30/1, i cili garanton një standard minimal për masën e përfitimit mujor për të gjitha llojet e pensionit, në masën 18 mijë lekë duke filluar nga viti 2024, dhe për të vijuar me një progresion rritës në 5 vitet e ardhshme, për të arritur në masën 32 mijë lekë në vitin 2029.

Neni 2 parashikon heqjen e një togfjalëshi në fjalinë e parë dhe të dytë, të nenit 62, pika 3, nëpërmjet të cilës zhbëhet kushtëzimi i tërheqjes së pensionit tre vitet e fundit, duke garantuar që pensionisti gëzon të drejtën e marrjes së përfitimit që i takon në cdo kohë.

Neni 3 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, në përputhje neni 83, pika 4 të Kushtetutës.

V. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon efekte financiare për Buxhetin e Shtetit, të cilat do të përlogariten pasi të merret mendimi i Këshillit të Ministrave, në përputhje me nenin 82, pika 2, të Kushtetutës së Shqipërisë.

DEPUTETI

Gazment BARDHI

